


Tregtia e jashtme e mallrave

Shkurt 2019

Tiranë, më 18 Mars 2019: Në Shkurt 2019 eksportet e mallrave arritën vlerën 23 mld lekë, duke u ulur me 5,4 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe rritur me 3,4 %, në krahasim me Janar 2019. Importet e mallrave arritën vlerën 50 mld lekë, duke u rritur me 8,1 %, në krahasim me një vit më parë dhe me 17,9 %, në krahasim me Janar 2019. Deficiti tregtar i këtij muaji është 27 mld lekë, duke u rritur me 22,6 %, krahasuar me Shkurt 2018 dhe me 33,6 %, në krahasim me Janar 2019.

Fig. 1 Ndryshimi vjetor në Tregtinë e mallrave (%)




Në dymujorin e parë të vitit 2019 eksportet e mallrave arritën vlerën 44 mld lekë, duke u ulur me 6,3 %, krahasuar me një vit më parë dhe importet e mallrave arritën vlerën 92 mld lekë, duke u rritur me 1,1 %, krahasuar me një vit më parë. Deficiti tregtar arriti vlerën 47 mld lekë, duke u rritur me 9,1 %, krahasuar me 2018.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:

Ulja vjetore e eksporteve prej 5,4 %, këtë muaj është ndikuar kryesisht nga grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -5,1 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -2,8 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -0,3 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të eksporteve ka ndikuar pozitivisht grupi: “Ushqime, pije, duhan” me +1,9 pikë përqindje.

Fig.2 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Shkurt 2019




Eksportet, gjatë këtij dymujori janë ulur me -6,3 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar negativisht në uljen vjetore të eksporteve, janë: “Materiale ndërtimi dhe metale” me -4,7 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -3,1 pikë përqindje, Tekstile dhe këpucë” me -0,9 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të eksporteve ka ndikuar pozitivisht grupi: “Ushqime, pije, duhan” me +1,3 pikë përqindje.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:

Rritja vjetore e importeve prej 8,1 %, këtë muaj është ndikuar kryesisht nga grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +6,5 pikë përqindje, “Produkte kimike dhe plastike” me +1,0 pikë përqindje, “Prodhime druri dhe letre” me +0,8 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të importeve ka ndikuar negativisht grupi: “Materiale ndërtimi dhe metale” me -1,1 pikë përqindje, etj.

Fig.3 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Shkurt 2019



Si dymujor, importet janë rritur me 1,1 %, krahasuar me dymujorin e parë 2018. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të importeve, janë: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +2,2 pikë përqindje, “Ushqime, pije, duhan” dhe “Prodhime druri dhe letre” me +0,2 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të importeve ka ndikuar negativisht grupi: “Materiale ndërtimi dhe metale” me -0,8 pikë përqindje.

Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere


Në muajin Shkurt 2019, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me Shkurt 2018 janë: Kosova (61,2 %), Gjermania (7,2 %), dhe Greqia (2,3 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe janë: Italia (-4,1 %), Spanja (-22,9 %), dhe SHBA (-16,1 %).

Gjatë këtij dymujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, janë: Kosova (18,7 %), Maqedonia (3,4 %) dhe Turqia (142,9 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Italia (-3,2 %), Gjermania (-3,0 %), dhe Greqia (-12,6 %).

Në muajin Shkurt 2019, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me Shkurt 2018 janë: Turqia (21,1 %), Kina (12,7 %) dhe Gjermania (8,2 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: Italia (-5,6 %), Greqia (-1,8 %) dhe Rusia (-10,1 %).

Gjatë këtij dymujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë: Kina (16,2 %), Turqia (5,7 %) dhe Rusia (16,3 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Italia (-9,5 %), Greqia (-1,7 %) dhe Gjermania (-1,8 %).

Fig.4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Shkurt 2019



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE zënë 67,3 %, të gjithë tregtisë. Në Shkurt 2019, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 80,1 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 61,5 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (34,2 %), Greqia dhe Gjermania (6,7 %), dhe Turqia (6,1 %).

Shkëmbimet tregtare, për dymujorin e parë 2019, me vendet e BE zënë 66,3 % të gjithë tregtisë. Në periudhën Janar – Shkurt 2019, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 82,0 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 58,7 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (34,5 %), Greqia (6,9 %), Kina (6,7 %) dhe Gjermania (6,3 %).

Tab. 1 Qarkullimi i mallrave

Vitet	Muajt	Eksporte (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Importe (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Bilanci Tregtar (mld lekë)	Mbulimi (%)
2000		37	-23,5	157	-1,5	-120	23,6
2001		44	19,1	190	21,0	-146	23,2
2002		47	7,7	210	10,6	-163	22,6
2003		54	14,7	226	7,4	-172	24,1
2004		62	14,0	236	4,5	-174	26,3
2005		66	6,0	262	11,1	-196	25,1
2006		77	17,6	299	14,1	-222	25,9
2007		97	25,5	376	25,8	-279	25,8
2008		113	15,8	440	16,9	-327	25,6
2009		105	-7,2	429	-2,5	-324	24,4
2010		162	54,6	478	11,4	-316	33,8
2011		197	21,9	544	13,9	-347	36,2
2012		213	8,2	528	-2,9	-315	40,3
2013		246	15,7	517	-2,1	-271	47,6
2014		256	3,8	552	6,7	-296	46,3
2015		243	-4,9	545	-1,4	-302	44,7
2016		243	0,1	579	6,4	-336	42,0
2017		273	12,1	626	8,1	-353	43,6
2018		310	13,7	641	2,4	-331	48,4
2017	01 - 17	19	15,6	35	0,9	-16	53,8
	02 - 17	20	14,2	44	5,1	-24	45,7
	Janar - Shkurt 17	39	14,9	79	3,2	-40	49,3
2018	01 - 18	24	24,5	45	27,5	-21	52,5
	02 - 18	24	18,8	46	4,4	-22	52,0
	Janar - Shkurt 18	47	21,5	91	14,7	-43	52,3
2019	01 - 19	22	-7,3	42	-6,2	-20	51,9
	02 - 19	23	-5,4	50	8,1	-27	45,5
	Janar - Shkurt 19	44	-6,3	92	1,1	-47	48,5

Tab. 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë)

	Eksporte				Importe			
	Shkurt 2018	Shkurt 2019	Jan.- Shk. 2018	Jan.- Shk. 2019	Shkurt 2018	Shkurt 2019	Jan.- Shk. 2018	Jan.- Shk. 2019
Vendet e BE-së	18.907	18.109	38.121	36.450	28.477	30.514	55.112	53.884
Austri	156	153	332	512	541	447	911	854
Mbretëri e Bashkuar	39	50	80	106	470	422	821	755
Gjermani	1.105	1.185	2.332	2.263	3.366	3.641	6.376	6.262
Greqi	948	970	2.142	1.872	3.915	3.845	7.598	7.468
Itali	12.336	11.834	24.816	24.016	13.651	12.890	25.415	23.002
Spanjë	2.223	1.713	4.109	3.180	845	656	1.790	1.123
Kroaci	64	97	118	145	525	422	940	853
Të tjera të BE-së	2.036	2.106	4.192	4.356	5.163	8.191	11.261	13.566
Kinë	890	194	1.620	741	3.399	3.831	7.244	8.418
Kosovë	1.217	1.961	2.570	3.050	472	539	881	809
Maqedonia	426	568	918	949	557	631	1.033	1.132
Rusi	6	20	6	21	1.035	930	1.662	1.934
SHBA	395	331	852	652	606	765	1.357	1.591
Turqi	106	224	210	509	3.473	4.208	7.344	7.760
Ukrainë	24	20	24	36	322	50	395	476
Zvicër	562	34	668	86	743	2.219	2.515	3.670
Të tjera	1.341	1.133	2.443	1.951	6.841	5.952	13.228	12.054
Gjithsej	23.875	22.594	47.431	44.443	45.924	49.638	90.773	91.728

Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milionë lekë)

Grup-mallrat	Eksporte				Importe			
	Shkurt 2018	Shkurt 2019	Jan.- Shk. 2018	Jan.- Shk. 2019	Shkurt 2018	Shkurt 2019	Jan.- Shk. 2018	Jan.- Shk. 2019
Gjithsej	23.875	22.594	47.431	44.443	45.924	49.638	90.773	91.728
Ushqime, pije, duhan	1.808	2.257	3.591	4.227	7.669	7.832	15.057	15.274
Minerale. lëndë djegëse. en.el.	4.378	3.159	7.985	6.504	4.288	7.260	11.514	13.477
Produkte kimike dhe plastike	473	475	798	990	6.278	6.755	12.123	12.033
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	209	212	465	434	1.429	1.359	2.621	2.511
Prodhime druri dhe letre	725	728	1.434	1.501	1.548	1.917	3.183	3.362
Tekstile dhe këpucë	10.047	9.967	20.613	20.195	6.697	6.756	12.954	12.708
Materiale ndërtimi dhe metale	4.306	3.644	8.660	6.453	6.065	5.571	10.857	10.152
Makineri. pajisje dhe pj. këmb.	1.264	1.417	2.588	2.820	10.180	10.502	19.203	19.111
Të tjera	665	735	1.297	1.319	1.769	1.686	3.262	3.099

Tab. 4 Të dhënat progresive të eksporteve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milione lekë)

	Itali		Kosovë		Spanjë		Gjermani	
	2018	2019	2018	2019	2018	2019	2018	2019
Gjithsej	24.816	24.016	2.570	3.050	4.109	3.180	2.332	2.263
Ushqim. pije duhan	1.267	1.297	242	358	130	226	228	223
Minerale. lëndë djegëse. energji elektrike	537	661	185	876	3.392	2.556	330	244
Produkte kimike dhe plastike	239	319	116	215	10	3	6	11
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	371	366	1	1	24	22	1	3
Prodhime druri dhe letre	1.025	1.095	67	114	-	1	22	23
Tekstile dhe këpucë	16.053	15.820	15	9	482	352	1.359	1.158
Materiale ndërtimi dhe metale	3.047	2.318	1.694	1.175	63	18	92	250
Makineri. pajisje dhe pjesë këmbimi	1.581	1.503	97	79	2	2	173	245
Të tjera	697	637	152	222	6	1	120	106

Tab. 5 Të dhënat progresive të importeve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milione lekë)

	Itali		Kinë		Turqi		Greqi	
	2018	2019	2018	2019	2018	2019	2018	2019
Gjithsej	25.415	23.002	7.244	8.418	7.344	7.760	7.598	7.468
Ushqim. pije duhan	2.643	2.633	87	187	791	782	2.196	2.052
Minerale. lëndë djegëse. energji elektrike	2.105	1.105	0	0	60	80	1.625	1.697
Produkte kimike dhe plastike	2.292	2.477	781	876	1.032	1.090	968	975
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	2.052	2.094	124	95	32	38	11	5
Prodhime druri dhe letre	1.022	940	165	108	400	438	429	433
Tekstile dhe këpucë	6.594	6.104	1.535	1.519	2.276	2.498	586	558
Materiale ndërtimi dhe metale	2.994	2.485	968	1.193	1.525	1.753	1.209	1.163
Makineri. pajisje dhe pjesë këmbimi	4.906	4.445	2.938	3.815	902	840	372	362
Të tjera	807	719	646	624	325	242	204	223

Përkufizime

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv ose të rieksportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit, edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore.

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Mbretëria e Bashkuar, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci.

Shpjegimi i simboleve

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

(-) pa vlerë

(÷) deri